



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.391/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit J.K., person përgjegjës i Barnatores (QKMF) me seli në Lipjan Rr. “Tahir Sinani”, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë Inspektorati Shëndetësor, për shkak të anulimit të Vendimit 05-6537 të datës 15.11.2019, jashtë seancës, me datë 28.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET poshtë padia e paditësit J.K., person përgjegjës i Barnatores (QKMF) me seli në Lipjan Rr. “Tahir Sinani”, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë Inspektorati Shëndetësor, për shkak të anulimit të Vendimit 05-6537 të datës 15.11.2019, si e paplotësuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi J.K., person përgjegjës i Barnatores (QKMF) me seli në Lipjan Rr. “Tahir Sinani”, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë Inspektorati Shëndetësor, për shkak të anulimit të Vendimit 05-6537 të datës 15.11.2019

Gjykata me datë 05.01.2024 paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar paditësin që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’u paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për

Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore. Dërgesa është kthyer në gjykatë si e pasuksesshme me konstatim se pala e panjohur në adresën e dhënë.

Duke vepruar konform Nenit 114 të LPK, ku përcaktohet se *në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës*, gjykata me datë 14.03.2024 publikoj thirrjen për plotësim të padisë me adresë të saktë të paditësit, konform nenit 99 dhe nenit 253 të LPK dhe për pagesë të taksës e cila qëndroj e publikuar 7 ditë, dhe edhe pas kalimit të afatit prej 8 ditëve gjykata nuk ka pranuar të dhënat e kërkuara e qe *e pamundësojnë zhvillimin e procedurës.*

Andaj, bazuar ne Ligjit për Konfliktet Administrative, nenit 33 nenit 33, Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që: *brenda afatit prej tetë (8) ditëve t'i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, dhe Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.*

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.391/22, datë 28.03.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.